

MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 140, dt. 16.07.2015

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, "*Për Trashëgiminë Kulturore*", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 16.07.2015, pasi shqyrtoi relacionin për problematikat e dala gjatë punimeve të zbatimit në Kishën e Ristozit, diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e punimeve të paparashikuara në preventivin fillestar, të dala gjatë zbatimit të punimeve në Kishën e Ristozit, Mborje, Korçë .
 - Të mos priset brezi beton/arme ekzistues dhe shtresa beton/arme mbi kupolë.
 - Të bëhet heqja e betonit të degraduar dhe të bëhet plotësimi dhe nivelimi me llaç horasan i shtresës së kupolës.
 - Të bëhen radhët e kornizave të qemereve me dy radhë sipas modelit të qemerit original.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

